

20191241760

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDOMISË SË VERIUT TË OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA TË DEDIKUAR PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR NDËRTIMININ DHE INSTALIMIN E SISTEMIT ELEKTRONIK PËR ARKËTIMIN E TAKSAVE RRUGORE PËRGJATË KORRIDORIT VIII DHE AUTOSTRADËS MILLADINOV-C-SHTIP, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedomisë së Veriut e garanton përbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financimin e Projektit për ndërtiminin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin e taksave rrugore, përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinovc-Shtip, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 13.000.000 eurosh, nëse Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe servison obligimet e Marrëveshjes për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për financimin e Projektit për ndërtiminin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin e taksave rrugore përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinovc-Shtip.

Neni 3

Të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati i pagesë së huas nga neni 1 i këtij ligji, është 15 vite e 6 muaj, me grejs periudhë të përfshirë prej 4 vitesh. Pagesën Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do ta kryejë në 24 këste gjysmëvjetore që arrijnë për pagesë më 10 qershor dhe 10 dhjetor çdo vit, siç është përcaktuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Shkalla e kamatës është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR gjashtëmuajor të rritur për margjinë prej 1%.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njehershëm në shumë prej 1% të shumës së huas.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion në shumë prej 0,5% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin Marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Qarkullimi i shërbimeve dhe të mirave të kryera ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për Projektin për ndërtimin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin e taksave rrugore përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinovc-Shtip, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtë heqjeje të tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave nga Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për Projektin për ndërtimin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin e taksave rrugore përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinovc-Shtip, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet imoportuese, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave për udhëtarë dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, për qëllime të Projektit për ndërtimin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin e taksave rrugore përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinovc-Shtip, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin e njëjta është detyrës tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi për llogaritje dhe pagesë të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Detyrësi tatimor që kryen qarkullim për të cilin lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në fakturë e shënon edhe emrin e projektit dhe titullin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore gjatë imortit të të mirave të liruara sipas paragrafit 2 të këtij neni, organit kompetent tatimor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit për ndërtimin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin e taksave rrugore përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinovc-Shtip, të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 7

Malli që ka qenë i liruar nga pagesa e detyrimeve imoportuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, në afat prej tre vitesh nga dita e importit, nuk guxon të tjetërsohet, t'i jepet për shfrytëzim tjetrit, të huazohet ose të përdoret ndryshe për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat është liruar nga pagesa e detyrimeve imoportuese, para pagesës së detyrimeve imoportuese. Sendet e atilla nuk guxon të jepen peng, të huazohen ose të jepen si sigurim për obligime tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para kalimit të afatit nga paragrafi 1 të këtij neni, mallin e liruar nga pagesa e detyrimeve imoportuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, ka për qëllim ta përdorë për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat është liruar nga pagesa e detyrimeve imoportuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Shumën e borxhit doganor nga paragrafi 2 të këtij neni, organi doganor e llogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në fuqi në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagesën e borxhit doganor.

Në rast të mospërmbajtjes ndaj dispozitave nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, shuma e borxhit doganor llogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në momentin e pranimit të deklaracionit doganor, në bazë të të cilit malli është liruara nga pagesa e detyrimeve imoportuese.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditë e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.